



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Tetor - Dhjetor 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, për periudhën kohore Tetor - Dhjetor 2024.

Aktakuzë për Vrasje të Rëndë

Prizren, 01 Tetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit S.H., shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili gjendet në paraburgim nga data 30.08.2024, pas ekstradimit nga Mbretëria e Bashkuar, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “Vrasja e rëndë” nga neni 179 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Sipas aktakuzës, me datë 04.06.2013 në periudhën kohore prej orës 03:23^{min} dhe 06:47^{min}, në Prizren, me dashje privon nga jeta në mënyrë mizore dhe tinzare nga motivet e ulëta së bashku me tani të dënuarin S.K., – viktimën I.K., në atë mënyrë që së bashku me S.K., nga Shkodra-Republika e Shqipërisë, vjen për të vizituar I.K., e cila ishte duke punuar si këngëtare-valltare në Mitrovicë në lokalin “Sh.”, pronë e M.S., me ç’rast takohen në Prizren, ku qëndrojnë në shtëpinë e F.R., ku ajo ka banuar më herët. Pasi që familja nuk është pajtuar lidhur me punën e saj si valltare dhe këngëtare në lokalet e natës, dhe pasi e njëjta nuk është pajtuar të kthehet në shtëpi, papritmas i pandehuri S.H., me thikë së bashku me S.K., fillojnë të godasin I.K., në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar plagë prerëse - shpuese, me ç’rast ka ardhur deri te vdekja e dhunshme si pasojë e gjakderdhjes masive të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të prehtë, e që është konstatuar sipas raportit të autopsisë së kryer me datë 05.06.2013.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor - Dhjetor 2024

Njoftim lidhur me Aksionin e Prokurorisë së Prizrenit kundër Fajdesë

Prizren, 02 Tetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se, pas një hetimi disa mujor në bashkëpunim me Njësinë Rajonale të Policisë në Prizren, Drejtorinë për Krim të Organizuar dhe Njësinë NJSO, është realizuar kontroll në tri lokacione, me ç’rast janë arrestuar tre të dyshuar A.Th., I.Th., dhe J.Th., për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 2, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Të pandehurit e arrestuar, dyshohet se duke shfrytëzuar gjendjen e rënduar financiare të viktimës, të njëjtit i kanë dhënë të holla me kamata mujore prej 25%. I dëmtuari disa herë ka paguar kamata, dhe kur i njëjti nuk ka arritur që t’i pagaj kamatat mujore, të pandehurit i kanë vënë kamata javore, me ç’ rast si rezultat i kamatave të larta, kanë arritur vlera të pa përballueshme për viktimën.

Kontrolli është realizuar në regjionin e Prizrenit, ku pas grumbullimit të provave gjatë aplikimit të masave të veçanta hetimore në terren, të pandehurit janë arrestuar.

Gjatë këtij aksioni, Prokurori i Shtetit, ka sekuestruar dy (2) automjete, të holla të gatshme dhe prova tjera materiale, në drejtim të veprës së lartëcekur.

Të pandehurit e arrestuar, gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh, dhe brenda afatit ligjor, për të njëjtit, prokuroria do të parashtrojë kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.


Prokuroria e Prizrenit, Inspektorët dhe Policia në Prizren Takohen për Luftimin e Veprave Penale Kundër Mjedisit

Prizren, 03 Tetor 2024 – U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, priti në takim pune Inspektorët nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, inspektorët komunal dhe përfaqësues nga policia për Rajonin e Prizrenit, lidhur me trajtimin e veprave penale kundër mjedisit. Po ashtu, në këtë takim morën pjesë edhe prokurorë nga Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie, duke përfshirë koordinatorin për trajtimin e veprave penale kundër mjedisit.

Temë kryesore e këtij takimi ishte ndotja dhe degradimi i mjedisit në regionin e Prizrenit.



U.D. Kryeprokurori Petrit Kryeziu, theksoi se shqetësuese janë rastet e shumta të nxjerrjes ilegale të zhavorrit dhe rërës përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë, si dhe operimi ilegal i separacioneve.



Nga të pranishmit, u kërkua bashkëpunim dhe koordinim sa i përket trajtimit të këtyre rasteve, për të ndërmarrë veprime aktive në drejtim të zbulimit dhe kapjes së kryesve të veprave penale që lidhen me degradim të mjedisit, po ashtu u kërkua ndërmarrja e veprimeve aktive në drejtim të sekuestrimit të mjeteve të kryerjes së veprave penale dhe dobisë pasurore.

Të gjithë të pranishmit, u pajtuan që në të ardhmen të kenë takime të ngjashme, me qëllim ngritjen e bashkëpunimit ndër institucional dhe luftimin e kësaj dukurie.

Prokuroria Themelore në Prizren, mbetet e përkushtuar maksimalisht në luftimin e dukurive të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bënë thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e kësaj dukurie degraduese.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN


Tetor - Dhjetor 2024

Prokuroria e Prizrenit Mban Ligjërata Vetëdijësuese në Shkollat e Prizrenit

Prizren, 04 Tetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, përkatësisht dy prokuroret nga Departamenti për të Mitur, znj. Sahide Sefa dhe znj. Merita Kurtishi-Gaka, kanë realizuar ligjërata vetëdijësuese në shkollën Sh.F.M.U.“Emin Duraku” dhe në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren.



Nxënësit fillimisht, u njoftuan për punën dhe funksionimin e prokurorisë dhe për mënyrën se si trajtohen të miturit para institucioneve të drejtësisë.



Ligjërata me nxënës, kishe qëllim edukues dhe parandalues, fokus i veçantë i'u kushtua delikuencës së të miturve, dhunës në familje, pasojave të përdorimit të narkotikëve, ngacmimet seksuale etj.

Më tutje, nxënësit u njoftuan edhe për sanksionet ligjore që parashihen sipas ligjit për personat që kryejnë vepra penale brenda perimetrit të shkollës dhe jashtë saj.


Pas prezantimit, vijoi diskutimi i hapur me nxënës. Prokuroret, i'u përgjigjën interesit të nxënësve, të cilët u fokusuan mbi aspekte të ndryshme.

Prokuroria Themelore në Prizren, do të vazhdoj edhe më tej, të mbajë ligjërata vetëdijësuese, me qëllim të parandalimit të dukurive negative dhe të veprave penale ku kryes janë të miturit, dhe për veprat penale të kryesve madhor ndaj të miturve.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor - Dhjetor 2024

Aktakuzë për Vrasje në Tentativë dhe Armëmbajtje pa Leje

Prizren, 07 Tetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B.U., i cili gjendet në paraburgim nga data 15.07.2024, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprat penale “Vrasja në tentativë” nga neni 172 lidhur me nenin 28, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Sipas aktakuzës, i akuzuari B.U., me datë 17.05.2024, rreth orës 17:30 min, në fshatin Nashec të Komunës së Prizrenit, me dashje tenton ta privojë nga jeta personin tjetër, në atë mënyrë që pasi takohet me viktimën J.A., paraprakisht kërkon nga i njëjti t’ia jap një shumë parash prej 2,500.00 € (Dymijë e pesëqind euro) në formë të borxhit dhe pasi viktimë i thotë se nuk e posedon një shumë të tillë, i njëjti nxjerr pistoletën dhe nga dritarja e automjetit të markës “WV Passat CC” , e cila ka qenë e hapur, shkrep



në drejtim të viktimës, me ç’rast e plagos në këmbën e tij të djathtë dhe largohet nga vendi i ngjarjes, si pasojë e lëndimeve të marra, viktima i nënshtrohet tretmanit mjekësor pranë Repartit Kirurgjik të Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit. Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Vrasja në tentativë” sipas KPRK-së.

Po ashtu, i akuzuari B.U., mban në pronësi, kontroll dhe posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, dhe me këto veprime ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprat penale për të cila akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor- Dhjetor 2024

Prokuroria e Prizrenit për Një Muaj ka Ngritur 192 Aktakuza



Prizren, 08 Tetor 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, gjatë muajit Shtator 2024, ka ngritur gjithsej njëqind e nëntëdhjetë e dy (192) aktakuza, kundër dyqind e gjashtëdhjetë (260) personave, për raste të ndryshme penale.

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, janë ngritur gjashtë (6) aktakuza kundër trembëdhjetë (13) personave.



Në Departamentin për të Mitur, janë ngritur njëzet (20) propozime për shqiptimin e masave edukative, të diversitetit ose dënimeve, kundër tridhjetë e nëntë (39) të miturve. Ndërsa, Departamenti i Përgjithshëm, i kësaj prokurorie gjatë muajit Shtator, ka ngritur njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (166) aktakuza kundër dyqind e tetë (208) personave, për vepra të ndryshme penale.

Prokuroria Themelore në Prizren, mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Tetor - Dhjetor 2024

Prokuroria e Prizrenit Brenda Javës ka Ngritur 64 Aktakuza Kundër 77 Personave

Prizren, 28 Tetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren brenda javës, përkatësisht për pesë ditë pune, nga data 21 – 25 Tetor 2024, ka ngritur gjashtëdhjetë e katër (64) aktakuza kundër shtatëdhjetë e shtatë (77) personave, për vepra të ndryshme penale. Këto aktakuza janë ngritur nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.



Nga numri total i këtyre aktakuzave, pesë (5) aktakuza kundër pesë (5) personave, janë aktakuza për dhunë në familje.

Përfaqësuesit Zviceranë të KFOR-it Vizitojnë Prokurorinë e Prizrenit

Prizren, 30 Tetor 2024 - Sot, më 30 tetor 2024, koordinatorja e rasteve të dhunës në familje, prokurorja Mehreme Hoxha zhvilloi takim me përfaqësues të KFOR-it zviceran (SWISSCOY/KFOR) për të diskutuar trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë. Me kërkesë të përfaqësuesve zviceranë, takimi u fokusua në analizimin e bazës ligjore dhe praktikave aktuale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në regjionin e Prizrenit.

Gjatë bisedës, përfaqësuesit e KFOR-it zviceran shprehën interes të veçantë për mënyrën se si rastet e dhunës në familje trajtohen në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, diskutimet përfshinë edhe statistikën e rasteve të regjistruara gjatë vitit 2024, masat mbrojtëse të ofruara për viktimat e dhunës në familje dhe vlerësimin e rrezikut për viktimat. Një tjetër temë kyçe ishte programi rehabilitues për kryesit e dhunës, i cili synon të ndihmojë në ndryshimin e sjelljeve dhe reduktimin e përsëritjes së rasteve të dhunës në familje.

Koordinatorja e rasteve të dhunës në familje, ndau përvojat dhe sfidat që prokuroria e Prizrenit përballë gjatë trajtimit të këtyre rasteve. Në këtë takim, u vu në dukje përpjekja për të siguruar mbrojtje efikase për viktimat dhe për të zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat e të dyja palëve për të ulur shkallën e dhunës në familje.



Përfaqësuesit e KFOR-it zviceran shprehën mirënjohje për informacionin e ndarë dhe për pritjen e ngrohtë, duke theksuar gatishmërinë e tyre për të ofruar mbështetje dhe për të forcuar bashkëpunimin për çështje të rëndësishme si kjo në të ardhmen.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor - Dhjetor 2024

Aktakuzë për Shitblerje të Narkotikëve

Prizren, 04 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B.B., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 dhe lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.7, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i akuzuari B.B., nga muaji Korrik 2024, e në vazhdim deri me datë 20.08.2024 në Prizren, pa autorizim, blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, substanca, psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri, blen substanca narkotike të llojit “marihuanë”, pasi e siguron substancën narkotike të njëjtën e ndan në sasi të vogla për shitje duke i ftuar blerësit përmes rrjetit social “Snap Chat”. I njëjti, me këtë rrjet social komunikon me përdorues të këtyre substancave narkotike, ku dakordohet për çmim dhe më pas kërkon nga të njëjtët që narkotikët të vijnë t’i marrin në lagjen “Ortakoll” në oborrin e njëres prej shkollave fillore në Prizren, ku edhe kryen shitjen dhe shpërndarjen e marihuanës në sasi prej 5-10 dozash. I njëjti, me datë 20.08.2024 rreth orës 12:15 arrestohet nga policia në flagrancë, me ç’ rast policia tek ai gjen dhe sekuestron substancë narkotike të llojit “marihuanë” në peshë prej 1.12 gram të sistemuara në tri (3) qese najloni.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor - Dhjetor 2024

Aktakuzë për Ngasje në Gjendje të Dehur dhe Posedim të Narkotikëve

Prizren, 08 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B.Q., i cili gjendet në paraburgim nga data 15.08.2024 deri me datë 15.11.2024, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprat penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”, nga neni 371 paragrafi 4 lidhur me par.1 dhe “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.2 lidhur me par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 15.08.2024 rreth orës 06:15^{min}, në rrugën Suharekë - Prizren, saktësisht në vendin e quajtur “Ura e Topliqanit” në Komunën e Suharekës, i pandehuri B.Q., duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes”, në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, drejton automjetin pa patentë shofer dhe nën ndikimin e alkoolit, me sasi të alkoolit në ajër prej 0.68 promila, ashtu që në këtë gjendje të dehur sa ishte duke lëvizur përgjatë rrugës Suharekë - Prizren, me të kaluar vendin e quajtur “Ura e Topliqanit”, në kthesën e ashpër në të djathtë nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes, humb kontrollin e automjetit dhe kalon në shiritin e kundërt të rrugës, dhe godet veturën tjetër të tipit “Audi 89” të cilën ishte duke e drejtuar tashmë i ndjeri A.Q., i cili mbetet i vdekur në vendin e ngjarjes, përderisa pasagjeri B.G., i cili ishte në veturën e të pandehurit pëson lëndime të rënda trupore, të përshkruara sikurse në akt ekspertimin mjeko – ligjor. Me këto veprime, ka kryer veprën penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”, nga neni 371 i KPRK-së.

Po ashtu, me datë 15.08.2024, rreth orës 08:00^{min}, në Suharekë, saktësisht në objektin e emergjencës, pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që pasi merr trajtimin mjekësor, shkon në tualetin e emergjencës, e hedh një qese plastike me substancë të dyshuar për narkotik, të cilën zyrtarët policor e



gjejnë dhe e njëjta dëshmi më datë 15.08.2024 ekzaminohet përmes testit fushor “M.M.C. International B.V. Cannabis Test” (i njohur ndërkomtarisht) dhe e njëjta rezulton pozitiv për prezencë të narkotikut, me peshë prej 1.13 gram me prezencë të canabisit - marihuana. Me këto veprime B.Q., , ka kryer veprën penale “posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Po ashtu prokurori i çështjes, ka propozuar vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit.

Prokuroria e Prizrenit me Aksion Kundër Degradimit të Mjedisit

Prizren, 11 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe me inspektorë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë realizuar dy aksione të ndara në Prevallë kundër degradimit të ambientit.

Në të dyja rastet, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e parkut kombëtar “Sharri”, janë sekuestruar tre (3) eskavator dhe një (1) kamion si mjete të kryerjes së veprës penale, pajisje me të cilat ilegalisht po degradohej mjedisi, dhe është iniciuar rast në drejtim të veprës penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Brenda afatit ligjor nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, në të dyja rastet e ndara janë duke u ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të lëshimit të urdhërit të përkohshëm ndalues dhe paraqitjes së kërkesës në gjykatë për lëshimin e urdhërit ndalues përfundimtar së bashku me masën e përkohshme përkatëse.




Prokuroria Themelore në Prizren, mbetet e përkushtuar maksimalisht në luftimin e dukurive të tilla të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bënë thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e kësaj dukurie degraduese.

Aktakuzë për Shitblerje të Narkotikëve

Prizren, 14 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit R.Ç., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri R.Ç., më datë 22.08.2024 rreth orës 11:15^{min} në Prizren, saktësisht në shtëpinë e tij, pa autorizim shpërndanë dhe ofron për shitje substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, dhe atë të llojit “kokainë” dhe “marihuanë”, në atë mënyrë që narkotikun e siguruar përmes rrugëve ilegale e mban në shtëpinë e tij nga ku fillon shitjen në sasi të vogla personave të ndryshëm në qytetin e Prizrenit.

Pas sigurimit të informatave operative lidhur me narkotikun që posedonte i pandehuri, sapo haset nga zyrtarët policorë në afërsi të rreth rrotullimit në lagjen “Bazhdarhana”, tentojnë ta ndalin mirëpo i njëjti arrinë të ikë në drejtim të shtëpisë së tij, ku edhe arrestohet dhe gjatë kontrollit të kryer, saktësisht në dhomën e tij, janë gjetur dhe sekuestruar: një qese brenda së cilës ishin tridhjetë qese plastike me substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë prej 32.03 gram, një qese me narkotik të llojit “marihuanë” me peshë 0.28 gram, një qese brenda së cilës janë njëzetë e tre qese plastike me substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë 13.79 gram, një çantë e zezë krahu me mbishkrimin “NIKE” brenda së cilës është një qese plastike me substancë të dyshuar narkotike të llojit “marihuanë” me peshë 177.18



gram, 3 qese me substancë narkotike të llojit “*kokainë*” me peshë prej 5.32 gram, gjashtë paketime me qese te zbrazëta që shërbejnë për paketim të narkotikëve dhe dy peshore “*constant*” ngjyrë e zezë dhe metalike, të cilat substanca narkotike pas ekzaminimit dhe ekspertimit nga Laboratori i Agjencisë Kosovare për Forenzikë, rezultojnë për narkotikë të llojit “*marihuanë*” me peshë të përgjithshme prej **223.28 gram**, si dhe narkotikë të llojit “*kokainë*” me peshë prej **5.32 gram**.


Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Aktakuzë për Lëndim të Rëndë Trupor me Pasojë Vdekjen

Prizren, 18 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve E.A., (shtetas Turk), dhe H.B., (shtetas Kosovar), të cilët gjenden nën masën e paraburgimit, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprat penale “Lëndimi i rëndë trupor” nga neni 186, par.5 lidhur me par.3, pika 3.2 lidhur me par.2, pika 2.1, “Mosdhënia e ndihmës” nga neni 188, par.4 lidhur me par.1 si dhe veprën penale “Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre” nga neni 378, par.1, pika 1.3 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri E.A., me datë 06.07.2024, rreth orës 23:50^{min}, në Prizren, me anë të mjetit të rrezikshëm, i shkakton lëndim trupor personit tjetër dhe për pasojë shkakton vdekjen e tij, në atë mënyrë që paraprakisht takohen me viktimën A.Th., nga Prizreni në lagjen “Kurillë”, me ç’rast viktimja ia kërkon telefonin të pandehurit me qëllim që ta njoftojë shokun e tij – të pandehurin tjetër H.B., dhe pasi që ky i fundit vjen me veturën e tij në lokacionin në fjalë, i pandehuri ulet në ulësen e pasme të automjetit, derisa viktimja në ulësen e përparme dhe pas një konfrontimi verbal me njëri – tjetrin, dalin nga vetura, me ç’rast i pandehuri me përdorimin e një mjeti të mprehtë, e godet viktimën në pjesën e përparme të këmbës, duke i shkaktuar plagë therëse, të konstatuara si në Raportin e Autopsisë – të datës 31.10.2024, dhe largohet nga vendi i ngjarjes, ku për pasojë, viktimja nga plagët e pësuar, pasi fillimisht pranon ndihmën mjekësore pranë Qendrës Emergjente në Prizren, dërgohet më pas pranë QKUK-së në Prishtinë, ku si pasojë e shokut hemorragjik edhe ndërron jetë.

Me këto veprime, i pandehuri E.A., ka kryer veprën penale “Lëndimi i rëndë trupor” sipas KPRK-së.



Ndërsa, i pandehuri H.B., me datë 06.07.2024, rreth orës 23:55 ^{min}, në Prizren, nuk i ofron ndihmë personit, jeta e të cilit ndodhej në rrezik të drejtpërdrejtë, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa rrezik të madh për veten, në atë mënyrë që pasi ishte duke e bartur viktimën A.Th., në veturën e tij, duke e ditur se ky i fundit ishte plagosur rëndë me mjet të rrezikshëm nga i pandehuri E.A., nuk e dërgon të njejtin pranë ndonjë institucioni të kujdesit shëndetësor, e lejon të dalë nga vetura dhe e lë në rrugë – në afërsi të rrethit të lagjes “Bazhdërhane” në Prizren dhe vazhdon rrugën me veturën e tij në drejtim të lagjes “Ortakoll”, ku si pasojë e plagëve të pësuar, përkatësisht si pasojë e shokut hemorragjik viktima edhe ndërron jetë pranë QKUK-së në Prishtinë. Po ashtu, i njëjti duke qenë në dijeni për identitetin e kryesit të veprës penale të lëndimit të rëndë trupor, nuk e njofton organin kompetent për një fakt të tillë, në atë mënyrë që pasi ka qenë në dijeni si dëshmitar okular në kryerjen e veprës penale nga E.A., megjithatë refuzon që ta njoftojë policinë apo organin tjetër kompetent lidhur kryerjen e veprës penale dhe identitetin e kryesit të saj. Në këtë mënyrë, i pandehuri H.B., ka kryer veprat penale “Mosdhënia e ndihmës” dhe “Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Aktakuzë Kundër Dy Personave për Rrëmbim

Prizren, 27 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve T.D., (shtetas i Republikës së Kosovës), dhe A.N., (shtetas i Republikës së Shqipërisë), të cilët gjenden nën masën e paraburgimit nga data 10.10.2024 për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje, kanë kryer veprën penale “Rrëmbimi” nga neni 191, par.2, pika 2.1 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 09.10.2024, rreth orës 21:15 në fshatin Gjonaj – Komuna e Prizrenit, të pandehurit T.D., dhe A.N., marrin dhe e mbajnë personin L.M., me qëllim të fitojnë dobi pasurore apo dobi tjera, ose me qëllim që ta detyrojnë atë apo personin tjetër që të kryejë ose të mos kryejë një veprim ose të durojë diçka, në atë mënyrë që shkojnë me automjetin e tyre në afërsi të shtëpisë së viktimës, të cilin e presin të dalë nga shtëpia, dhe në momentin kur i njëjti i afrohet automjetit të tyre, fillojnë paraprakisht ta godasin me shqelma dhe përmes forcës e fusin në veturë dhe largohen në drejtim të Shqipërisë, përmes rrugëve alternative – malore, duke iu shmangur kalimit të rregullt kufitar dhe në rrugë e sipër, pas një bashkëpunimi në mes së Policisë së Kosovës dhe asaj të Republikës së Shqipërisë, të njëjtit ndalohen nga e Policisë së Shqipërisë, të cilët shoqërohen në pikën kufitare të Qafë Prushit ku edhe i dorëzohen autoriteteve të Policisë së Kosovës, me ç’rast viktimë ka pranuar tretman mjekësor fillimisht pranë një Qendre të Mjekësisë Familjare në Gjakovë e më pas edhe pranë Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit. Po ashtu, prokurori i çështjes ka propozuar që të konfiskohet

vetura si mjet i cili u ka shërbyer dhe mundësuar të pandehurve kryerjen e veprës penale.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Tetor- Dhjetor 2024

Aktakuzë për Përdorim të Paautorizuar të Pasurisë dhe për Ushtrim të Kundërligjshëm të Veprimtarisë Mjekësore

Prizren, 27 Nëntor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve F.S., dhe T.D., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale “Përdorimi i paautorizuar i pasurisë” nga neni 420, dhe “Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” nga neni 256 par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri F.S., me datë 15.12.2023 në Prizren, rreth orës 22.30 min, pa autorizim përdorë pasurinë tjetër të luajtshme e cila i është besuar atij në detyrë apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij apo i jep pasurinë e tillë në shfrytëzim personit tjetër për shfrytëzim të paautorizuar, ashtu që duke punuar në cilësinë e mjekut Gjinekolog në repartin e Gjinekologjisë-Obstetrike në Spitalin e Prizrenit, ka pranuar për lindje pacienten-shtatzënë A.R., nga fshati Mushnikovë, e cila ka qenë në përcjellje të gjinekologes private T.D., edhe pse ishte mjek kujdestar në detyrë së bashku me mjekun tjetër M.B., nuk ndërmerr veprime zyrtare të cilat ka pasur për detyrë t’i ndërmarrë në parandalimin e mjekes T.D., që të hyjë në sallën e lindjes dhe ta kryejë lindjen. Me këto veprime, ka kryer veprën penale “Përdorimi i paautorizuar i pasurisë” sipas KPRK.

Ndërsa, e pandehura T.D., me datë 15.12.2023 në Prizren rreth orës 22:00 min, në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, Prim. “Daut Mustafa” pa pasur autorizimet ligjore kryen trajtime mjekësore – gjinekologjike duke mos qenë nëpunëse/mjeko pranë Spitalit të Prizrenit, me ç’rast pas ekzaminimit të pacientes A.R., në ambulancën



e saj private, ka konstatuar se rasti është për lindje, ashtu që e shoqëron pacienten në fjalë deri në repartin e Gjinekologjisë Obstetrike në spitalin e Prizrenit, dhe pa lejen e mjekëve kujdestar F.S., dhe M.B., pas pranimit në repart duke mos lejuar mjekun F.S., që të bëjë ekzaminimin e pacientes, si dhe përkundër reagimit të mjekut tjetër kujdestar M.B., ka shkuar drejt në sallën e lindjes dhe ka kryer lindjen e pacientes. Me këto veprime, e njëjta ka kryer veprën penale “Ushtimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” sipas KPRK.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

U.D. Kryeprokurori i Prizrenit Priti në Takim Përfaqësues të KFOR-it Zviceran

Prizren, 03 Dhjetor 2024 – U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, ka pritur sot në takim përfaqësues të KFOR-it zviceran (LMT).

U.D. Kryeprokurori Kryeziu, fillimisht falenderoi përfaqësuesit e KFOR-it zviceran, për angazhimin, përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre në mbështetje të regjionit të Prizrenit, duke vlerësuar rolin e tyre në ruajtjen e sigurisë, paqes dhe stabilitetit, gjatë përmbueshjes së detyrave të tyre.



Po ashtu, të njëjtit i njoftoi për organizimin dhe funksionimin kushtetues dhe ligjor të Prokurorisë së Prizrenit, me punët sfidat dhe synimet e kësaj prokurorie.

Gjatë bisedës, përfaqësuesit e KFOR-it zviceran shprehën interes të veçantë për sfidat e prokurorisë, bashkëpunimin me institucionet tjera të drejtësisë, transparencën dhe qasjen e qytetarëve në prokurori.

Një tjetër temë kyçe ishte edhe diskutimi për vepra penale specifike si dhuna në familje, veprat penale kundër mjedisit etj.

Përfaqësuesit e KFOR-it zviceran u shprehën të gatshëm për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Prokurorinë Themelore në Prizren, me qëllim të kontributit në sigurimin e paqes.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN **Tetor - Dhjetor 2024**

Prokuroria e Prizrenit Mban Ligjërata në Shkolla Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjimore

Prizren, 04 Dhjetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, përkatësisht prokuroret/koordinatore për rastet e dhunës në familje, znj. Mehreme Hoxha dhe znj. Elfete Purova, kanë realizuar ligjërata vetëdijësuese në shkollën e mesme Sh.M.L.M “Luciano Motroni” dhe në shkollën Sh.M.U. “Hysen Rexhepi” për klasat e nënta, në Prizren. Këto ligjërata janë mbajtur në kuadër të fushatës vetëdijësuese “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjimore”.



Nxënësve iu ligjërua rreth konceptit të marrëdhënieve familjare, formave të dhunës në familje, aspektet penale të dhunës në familje, viktimat e ndjeshme, si dhe rolin e

institucioneve shtetërore në luftimin e këtyre veprave penale. Ata u informuan gjithashtu, për ndihmën juridike që mund t'u ofrohet nga Qendra për Ndihmë Juridike, për rolin e mbrojtësve të viktimave etj.

Këto ligjërata kishin për qëllim forcimin e kapaciteteve të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për të identifikuar dhe raportuar dhunën në familje si dhe dhunën në baza gjinore.

Më tutje, nxënësit u njoftuan edhe për sanksionet ligjore që parashihen sipas ligjit për personat që kryejnë vepra penale të dhunës në familje, si dhe veprave tjera penale në kuadër të dhunës në familje.



Ligjëratat ishin interaktive dhe nxënësit shprehën interesim të madh gjatë ligjërimit, duke parashtruar pyetje të ndryshme për diskutim.

Prokuroria Themelore në Prizren, do të vazhdoj edhe më tej t'i trajtoj me prioritet rastet e dhunës në familje, dhe do të vazhdoj të mbajë ligjërata të tilla, me qëllim të

vetëdijësimit dhe të parandalimit të veprave penale të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Tetor- Dhjetor 2024

Prokuroria e Prizrenit Mban Tryezë Diskutimi për Rastet e Dhunës në Familje

Prizren, 06 Dhjetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, përkatësisht prokurorja/koordinatore znj. Mehreme Hoxha me mbështetjen e OSBE-së, ka organizuar tryezë diskutimi me prokurorë nga kjo prokurori dhe me gjyqtarë të regjionit të Prizrenit, si dhe bashkëpunëtorë profesional, me qëllim të bashkëbisedimit për kornizën ligjore për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Kjo tryezë diskutimi është mbajtur në kuadër të fushatës vetëdijësuese *“16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore”*.



Në këtë tryezë pune, në fjalën e tij, U.D. Kryeprokurori Petrit Kryeziu, theksoi se rastet e dhunës në familje janë problem global, dhe as vendi ynë nuk është imun ndaj tyre,

dhe se shteti duhet të jetë garantues dhe i gatshëm në luftimin e këtyre veprave penale.

Më tutje U.D. Kryeprokurori Kryeziu, theksoi se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, duhet të jetë prioritet i organeve të drejtësisë si dhe i të gjitha institucioneve në vend.

Ai përmendi gjithashtu, sfidat me të cilat ballafaqohet prokuroria në baza ditore për trajtimin e veprave penale të dhunës në familje.

Ndërsa, Daniel Lezo, përfaqësues i OSBE-së në Prizren, prezantoi të gjeturat e raportit të monitorimit të gjyqimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë, nga montitorimi i OSBE-së.



Në anën tjetër, prokurorja/koordinatore për rastet e dhunës në familje Mehreme Hoxha, theksoi faktin se rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje kanë prioritet në zgjidhjen e tyre, ku falë punës së mirë mekanizmit që mirren me trajtimin e këtyre rasteve është rritur edhe numri i raportimeve nga viktimat për këto vepra penale.

Ndërkaq, diskutimet e zhvilluara gjatë këtij takimi u fokusuan në zgjidhjen e problemeve të dhunës në familje, me theks të veçantë në trajtimin e personave që

vuajnë nga probleme të shëndetit mendor e që janë kryes të veprave penale të dhunës në familje, pastaj rastet e viktimave të ndjeshme, viktimat e përsëritura etj.

Gjithashtu, u potencua rëndësia e bashkëpunimit institucional, në mënyrë që viktimat e dhunës në familje të trajtohen me profesionalizëm dhe me dinjitet të plotë.

Prokuroria Themelore në Prizren, do të vazhdoj edhe më tej t'i trajtoj me prioritet rastet e dhunës në familje.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Tetor- Dhjetor 2024

Njoftim Lidhur me Rastin e Arrestimit të Një Personi për Veprat Penale Fajdeja dhe Organizimi i Skemave Piramidale dhe Bixhozit të Paligjshëm

Prizren, 10 Dhjetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren - Sektorin Rajonal të Hetimeve, ka arrestuar të pandehurin F.Sh., për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” nga neni 294, dhe “Fajdeja” nga neni 331, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I pandehuri i arrestuar, nga muaji Shtator i vitit 2023 dhe në vazhdimësi, deri në datën e arrestimit, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të dëmtuar, varfërinë dhe papërvojën e tij, në atë mënyrë që pasi i dëmtuari – viktimë, A.Z., nuk kishte pasur mundësi t’ia kthejë një borxh në shumën prej 70,000.00 €, të cilin borxh i detyrohej të pandehurit F.Sh., pasi që ky i fundit gjatë muajit Janar të vitit 2024, përmes një programi elektronik të lojërave të fatit, i kishte mundësuar të dëmtuarit të luaj bixhoz të paligjshëm, ashtu që në momentin kur viktimë kishte hasur në vështirësi që t’ia paguajë borxhin, i pandehuri arrin ta bindë viktimën që në emrin e tij do të angazhohet dhe t’ia sigurojë paratë, në mënyrë që t’ia krijojë kushtet të njëjtit për kthimin e borxhit.

Në këtë rast i pandehuri i arrestuar, i ofon viktimës para me fajde – me kamata të paligjshme fillimisht prej 15% pastaj 20% e deri në 25%, kështu duke i shkaktuar viktimës dëm të konsiderueshëm pasuror, i cili nuk kishte arritur t’ia paguajë shumën e mbetur të kamatës, gjegjësisht totalin e kamatës nga të gjitha huazimet e të hollave me fajde, që nga periudha e muajit Shtator të vitit 2023, e cila kap vlerën e përgjithshme prej 81,400.00 €.

I pandehuri është arrestuar në flagrante nga ana e Policisë së Kosovës duke pranuar të holla nga viktimë në emër të kamatave të paligjshme me të cilat e kishte ngarkuar të njëjtin.

I pandehuri i arrestuar, gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh, dhe për të njëjtin, prokuroria ka parashtruar kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN **Tetor- Dhjetor 2024**

Aktakuzë për Vrasje të Rëndë në Tentativë

Prizren, 18 Dhjetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve: H.L, Sh.L dhe A.L., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Vrasja e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173, të pandehurit I.L, dhe A.L., kanë kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184, të pandehurit H.L, I.L, H.L, Sh.L dhe Z.L., kanë kryer veprën penale “Lëndimi i rëndë trupor” nga neni 186, dhe H.L., Sh.L., I.L., kanë kryer veprën penale

“Mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 22.05.2024 rreth orës 19:15 minuta në fshatin Krajk-Komuna e Prizrenit, në afërsi të tyrbes së fshatit, të pandehurit H.L., Sh.L., dhe A.L., me dashje tentojnë ta privojnë nga jeta të dëmtuarin M.Q., po ashtu me dashje vënë rrezik jetën e dëmtuarave, Gj.B., dhe S.Q., si pasagjere në automjet, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari M.Q., ishte duke e drejtuar automjetin e tij, e që ishte duke udhëtuar në drejtim të Prizrenit, i pandehuri A.L., me automjetin e tij, iu del përpara duke ia prerë rrugën, dhe nga automjeti i tij, dalin të pandehurit H.L., A.L., Sh.L., dhe Z.L., i pandehuri A.L., me një shufër metalike në dorë niset në drejtim të automjetit të të dëmtuarit, me ç’ rast e godet me shufër metalike xhamin e përparmë të automjetit duke e thyer, në momentin kur i dëmtuari M.Q., e hap derën për të dalë jashtë, i pandehuri Sh.L. i pajisur me një pistoletë të tipit “Crvena Zastava 99, dhe i pandehuri H.L. i pajisur me një pistoletë të tipit “Zastava M83/98”, shtënë nga një largësi prej 4-5 metra në drejtimin e të dëmtuarit M.Q., duke e goditur të njëjtin në të dy këmbët, me ç’rast i kanë shkakuar dy plagë hyrëse – tej shkuese, ndërsa të dëmtuarave Gj.B., dhe S.Q., seriozisht me dashje u vënë në rrezik jetën, i dëmtuari M.Q., me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të Prizrenit.

Ndërkohë, afërsi të tyrbes së fshatit të pandehurit I.L., e A.L., të pajisur me një pistoletë në dorë i afrohen të dëmtuarit B.Q., i cili ishte duke qëndruar në afërsi të automjetit të tij, me ç’ rast përdorin forcë ndaj tij duke e goditur të njëjtin me pjesën e topitur të pistoletës.

Pastaj, të pandehurit, H.L., I.L., H.L., Sh.L., dhe Z.L., pas konfliktit në fshatin Krajk, nga aty i ndjekin me automjete të dëmtuarit M.Q., dhe B.Q., të cilët në automjete ishin me anëtarët e familjeve të tyre, e që ishin duke udhëtuar në drejtim të Prizrenit, në momentin kur vërejnë se të dëmtuarit janë ndalur tek pompa e benzinës “O..... OIL” zbresin nga automjetet e tyre, dhe i sulmojnë me mjete të forta dhe me armë zjarri, duke i shkakuar lëndime të rënda trupore

me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, lëndime këto të konstatuara në akt ekspertimin mjekoligjor në bazë të dokumenteve të çështjes të datës 06.09.2024 dhe plotësimi i mendimit të ekspertimit mjekoligjor datë 19.11.2024 punuar nga eksperti i mjekësisë ligjore.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Tetor- Dhjetor 2024

Prokuroria e Prizrenit Mban Takim Pune me Prokurorë, Gjyqtarë, Policë dhe Avokatë


Prizren, 20 Dhjetor 2024 – U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, me mbështetjen e OSBE-së ka organizuar tryezë diskutimi me prokurorë nga kjo prokurori, me gjyqtarë të regjionit të Prizrenit, përfaqësues të policisë për rajonin e Prizrenit si dhe me avokatë, me qëllim të bashkëbisedimit rreth bashkëpunimit ndërinstitutional në trajtimin e çështjeve penale.



Gjatë këtij takimi, në fjalën e tij, U.D. Kryeprokurori Petrit Kryeziu, theksoi se takimet e tilla janë një mundësi e rëndësishme për të forcuar përpjekjet tona të përbashkëta duke përmirësuar komunikimin, standardizuar klasifikimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, si dhe për të eksploruar mënyra për të përmirësuar menaxhimin e çështjeve dhe mbështetjen për viktimat.

Më tutje U.D. Kryeprokurori Kryeziu, theksoi se duke mbledhur të gjithë akterët kyç, synojmë të krijojmë përgjigje më kohezive dhe efektive ndaj krimit.





Ai, gjithashtu përmendi sfidat me të cilat ballafaqohet prokuroria në baza ditore për trajtimin e veprave penale të ndryshme duke adresuar edhe vetë kritika.

Po ashtu, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren znj. Shpresa Emra, Drejtori i Policisë Rajonale në Prizren kolonel Faton Alija dhe Kryetari i OAK dega në Prizren z. Blerim Mazreku, gjatë fjalës së tyre përmendën punën e institucioneve përkatëse, sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë punës së përditshme në luftimin e kriminalitetit, si dhe me qëllim të avancimit adresuan edhe shqetësime konstruktive për prokurorinë. Të pranishëm, gjykatës, prokurorë, avokatë dhe zyrtarë policorë, ishin pjesëmarrës aktiv në këtë tryezë diskutimi.

Takimi u konsiderua produktiv nga pjesëmarrësit, të cilët theksuan nevojën për vazhdimin e kësaj qasjeje bashkëpunuese për të garantuar që puna e këtyre institucioneve, përkatësisht e sistemit të drejtësisë të funksionojë në mënyrë transparente dhe në përputhje me standardet më të larta ligjore.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Tetor- Dhjetor 2024


Mbahet Takimi i Përmbyllës i Mekanizmit Koordinues për Rastet e Dhunës në Familje

Prizren, 24 Dhjetor 2024- Në Prokurorinë Themelore në Prizren është mbajtur takimi i rregullt (përmbyllës për vitin 2024), i mekanizmit koordinues me akterët të cilët merren me trajtimin e rasteve dhe veprave penale të dhunës në familje, brenda kompetencës së kësaj prokurorie.



Në këtë takim, thirrur dhe organizuar nga prokurorja dhe koordinatorja për rastet e dhunës në familje znj. Mehreme Hoxha, ishin të pranishëm prokurorja/koordinatorja znj. Elfete Purova, udhëheqësi i Departamentit të Përgjithshëm prokurori z.Atnor Skoro, përfaqësues nga Policia e Kosovës për regionin e Prizrenit, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale, përfaqësues nga Shërbimi Sprovues, mbrojtës të viktimave, si dhe përfaqësues nga OJQ.

Prokurorja Hoxha, njoftoi se në periudhën Janar – Nëntor 2024, Prokuroria Themelore në Prizren, ka pranuar treqind e njëzet e nëntë (329) kallëzime penale, lidhur me veprat penale të dhunës në familje. Ndërsa, gjatë kësaj



periudhe janë kryer gjithsej treqind e nëntëmbëdhjetë (319) lëndë të kësaj natyre.

Në këtë takim, të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan lartë bashkëpunimin që ekziston në mes institucioneve kompetente për trajtimin e këtyre rasteve, ku u theksuan të arriturat por edhe sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet gjatë punës së përditshme në trajtimin e këtyre rasteve.

Nga të pranishmit u potencua se rastet e dhunës në familje, janë rastet më të vështira për trajtim, sidomos sfiduese janë rastet kur kryes të këtyre veprave janë personat me çrregullime mendore. Po ashtu, u kërkua që në çdo rast të bëhet vlerësimi i rrezikut për viktimat e dhunës në familje, në mënyrë që të ndërmeren masa adekuate për mbrojtje të viktimave.

U diskutua edhe për lansimin e sistemit të hallkave për mbikëqyrje elektronike, dhe u theksua se pritet që së shpejti të funksionalizohen, dhe se të njëjtat do të ndikojnë në parandalimin e rasteve të dhunës në familje.

Në fund të takimit, të gjithë pjesëmarrësit u dakorduan që do të vazhdojnë bashkëpunimin, në mënyrë që të gjitha institucionet relevante t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre me përgjegjësi dhe profesionalizëm, në mënyrë që viktimat e dhunës në familje të trajtohen me profesionalizëm dhe me dinjitet të plotë.

Aktakuzë për Keqpërdorim të Pozitës Zyrtare

Prizren, 24 Dhjetor 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve S.M., F.T., E.M., F.M., dhe V.Sh., për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se në cilësinë e personave zyrtarë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 29.01.2021 në Mamushë, në cilësinë e personave zyrtarë - duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, në bashkëkryerje i tejkalojnë kompetencat e tyre me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojnë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkelin të drejtat e personit tjetër, në atë mënyrë që i pandehuri S.M., në cilësinë e Kryetarit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga vërshimet dhe shirat e rrëmbyeshëm në Komunën e Mamushës, ndërsa të pandehurit F.T., E.M., F.M., dhe V.Sh., – si anëtarë të komisionit, përpilojnë Raportin mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe listën prej 169 fermerëve përfitues të mbështetjes financiare publike në shumën prej 416,874.77 €, me ç'rast 43 fermerë nga 169 sosh si fermerë përfitues, janë përfshirë në listën e përfituesve në kundërshtim me opinionin ligjor të MBPZHR-së – të datës 17.07.2018 dhe në kundërshtim me Vendimin për shlyerjen e njërit NIF (Numri Identifikues i Fermës) të cilët kanë përfituar mbështetje financiare në shumën prej 97,456.61 € si dhe 13 persona të tjerë të cilët ishin futur në listën e përfituesve pa qenë fare fermerë, me ç'rast këta të fundit kanë përfituar shumën prej 22,936.70 €, me ç'rast i kanë shkaktuar dëm material buxhetit të Republikës së Kosovës në shumën prej 120,393.31 € (njëqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre euro e tridhjetë e një cent).

Me këto veprime, të pandehurit e lartëcekur kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Tetor- Dhjetor 2024

Aktakuzë për Shitblerje të Narkotikëve

Prizren, 27 Dhjetor 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve S.F., K.B., dhe E.Sh., të cilët gjenden nën masën e paraburgimit, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 275 parag. 1 nëparag. 1.1, 1.6 dhe 1.9, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, nga data e pavërtetuar e në vazhdimësi deri më datë 28.03.2024 pas mesnatës, në Prizren, Xërxe dhe Gjakovë, të akuzuarit duke vepruar në grup, pa autorizim blejnë, shpërndajnë dhe shesin në sasi të mëdha substanca narkotike të llojit “kokainë” të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë të ndaluar, në atë mënyrë që i akuzuari S.F., blenë substanca narkotike të llojit “kokainë” nga persona të panjohur dhe në pajtim me të akuzuarin E.Sh., i lë në ruajtje në shtëpinë e E.Sh., në Gjakovë.

Më pas i akuzuari S.F., me qëllim të barazimit të borxhit, me kërkesë të akuzuarit K.B., ofron “kokainë” për shitje në sasi prej 50.35 gram, ku i akuzuari K.B., me datë 02.10.2023 pas mesnate pas pranimit të kokainës në fshatin Xërxe,

me automjetin e tij, kthehet në lokalin i tij "S...." rreth orës 01:14 min., dhe sasinë e pranuar të kokainës nga i akuzuari S.F., ia shet personit tjetër në shumë prej 2000€ (dy mijë euro) , i cili ia ka bërë pagesën K.B., 1900 € (një mijë e nëntëqind euro) derisa pagesa prej 100€ (njëqind euro) është dashtë të bëhet në takimin e radhës për porosinë për 1 kg "kokainë".

Lidhur me këtë rast, me datë 28.03.2024, është kryer bastisje në shtëpinë e të akzuarit E.Sh., në Gjakovë, me ç' rast janë gjetur dhe konfiskuar:

Dy (2) qese plastike me substancë të llojit kokainë me peshë 147.78 gram,

Dy (2) qese plastike me substancë të llojit kokainë me peshë 52.01 gram,

Një (1) qese plastike me substancë të llojit kokainë me peshë 5.71 gram,

Një (1) qese plastike me substancë të llojit kokainë me peshë 2.82,

Një (1) qese plastike me substancë të dyshuar narkotike të llojit "mariuhanë" në peshë prej 0.95 gram,

Një (1) peshore digjitale ngjyrë e bardhë,

Një (1) peshore digjitale ngjyrë e zezë,

Tri (3) foli plastike,

Një (1) rrollne alumini,

Dy (2) shirita ngjitës.

Gjithashtu, në këtë çështje, paralel me hetimet penale prokurori i shtetit ka zhvilluar edhe hetime financiare sipas Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit të Pasurisë, ashtu që për pasuritë të cilave nuk u dihet prejardhja, që janë një shtëpi me sipërfaqe 250m² dhe trualli në sipërfaqe 421m² e cila gjendet në Prizren dhe një automjet i markës "Mercedes", pronë e të pandehurit K.B., në mungesë të procedurave të detajuara dhe të pamjaftueshme në Kodin e Procedurës Penale, për këto pasuri do të ndiqen rrugët ligjore të përcaktuara në LKZK.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.